



Pranimi / Detezimi Pranjenje / Predložak Koncesion / Delivery	16 - 06	2022	2	viti god year
Organi / Iqista Organ / Zastupnik Org / Other	SKPM/SHICK	3541/2022	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
				115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 405/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr. 2178/2019 të datës 23.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.405/2019 të datës 16.07.2019 të ankuesit me adresë banimi ne Rrugën nga Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.405/2019 të datës 16.07.2019 të parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQZHET Vendim me numër protokolli 01-111/01-0048306/19 i datës 04.07.2019 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- III. ANULOHET procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjimnazit “Frang Bardhi” e shpallur sipas konkursit të datës 05.04.2019 dhe çdo vendim që ka rrjedhë nga kjo procedurë.
- IV. OBLGOHET Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Mitrovicës së Jugut, me datën 02.04.2019, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazit "Frang Bardhi", ndërsa me datë 05.04.2019, ka shpallur konkursin për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazit "Frang Bardhi".

Ankuesi ka aplikuar në këtë pozitë, ndërsa pas përfundimit të procesit të rekrutimit i pakënaqur me njoftimin e datës 31.05.2019, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazit "Frang Bardhi", me datë 07.06.2019, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 07-111/01 - 0048306/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Mitrovicës së Jugut.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me datë 04.07.2019 ka nxjerr Vendim me numër protokoli 01-111/01-0048306/19, me të cilën e ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoli 01-111/01-0048306/19 të datës 04.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut, brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.07.2019 me numër protokoli 3172/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 23.07.2019, me numër protokoli 3285/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut ndërsa me datën 02.08.2019 me numër protokoli 3411/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kohën e parashtrimit të ankesës nga ankuesi ka qenë jofunksional rrjedhimisht nuk është shqyrtuar ankesën e ankuesit për këtë ankuesi përmes njoftimit të datës 03.09.2019, duke e udhëzuar që mund të inicioj konflikt administrativ sipas Ligjit për Konfliktet Administrative. Ankuesi ka hapur konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 23.05.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2178/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit (ankuesit) duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019 dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.405/2019 e datës 16.07.2019 me numër protokoli 3172/2019 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A.nr. 2178/2019, të datës 23.05.2022,

të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Vendimi i datës 04.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 07.06.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesa për fillimin e rekrutimit të datës 20.02.2019; Përshkrimi i detyrave të Punës; Organogrami i Shkollës; Autorizimi i datës 02.04.2019, i Ministrisë së Administratës Publike; konkursi i datës 05.03.2019; Kërkesa për punësim të ankuesit, me shkresat e bashkangjitura; Licenca e mësimdhënësit; Vërtetimi i datës 17.04.2019; Plani Zhvillimor i Shkollës; Diplomë e datës 30.07.2015; Diplomë e datës 01.03.2014; Kërkesa për punësim të kandidatës me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e vitit 2015; certifikatë e datës 22.01.2002; Vërtetimi i datës 16.04.2019; Diplomë e datës 04.03.2013; licenca e mësimdhënësit; Certifikatë e datës 17.11.2004; Plani Zhvillimor i Shkollës; Njoftimi i datës 03.09.2019, i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 01.08.2019, me numër protokollit 3411/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqë procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazit "Frang Bardhi" është zhvilluar në kohën kur i aplikueshëm ka qenë Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të të cilit drejtorët e institucioneve të arsimit kanë pasur statusin e nëpunësit civil, atëherë sipas Aktgjykimit A.nr. 2178/2019 të datës 23.05.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, do të shqyrtoj këtë rast sipas legjislacionit përkatës në fuqi në kohën e zhvillimit të kësaj çështje juridike-administrative.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut nuk ka arritur të konstatojë gjendjen faktike sepse kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e konkursit sepse nuk ka certifikatën e udhëheqësja arsimore siç kërkohet me konkurs dhe udhëzimin administrativ përkatës në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës, konstaton se në konkursin e datës 05.04.2019 të shpallur për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazit "Frang Bardhi", kriteret që kandidatët duhet t'i plotësojnë për emërim në këtë pozitë kanë qenë:

- *Të ketë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (240 ECTS/ 4 vite) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit;*
- *Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jetë në procedurë të licencimit;*
- *Të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucion të arsimit,*
- *Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim;*

Bazuar në provat e lëndës të dërguara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut me përgjigjen në ankesë më datë 02.08.2019, Kolegji, ka gjetur se kandidatja e përzgjedhur me rastin e aplikimit

në këtë pozitë nuk ka dorëzuar Certifikatën për përfundimin e programit *“Ndërtimi i Kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës”*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me qëllim të vendosjes në mënyrë sa më meritore, më datë 14.06.2022 kemi kërkuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut provë nëse kjo kandidatë posedon certifikatën e udhëheqjes në arsim, ndërsa më datë 15.06.2022 kemi pranuar përgjigje nga Komuna e Mitrovicës së Jugut duke pranuar Certifikatën për pjesëmarrje në projektin *“Trajnimi për drejtor të ardhëm për të gjitha tipet e shkollave”* të cilin e ka ndjekur kandidatja e përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se as kandidatja e përzgjedhur dhe as autoriteti punëdhënës nuk kanë sjell provë me të cilën dëshmohet se kjo kandidatë ka të kryer programin *Ndërtimi i Kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës*, i cili përveç që është kusht i konkursit i njëjti është kusht edhe sipas nenit 3 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e zhvillimit të kësaj procedurë, andaj, sipas kësaj Kolegji, konstaton se kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e kërkuar në konkurs dhe atë të kërkuar sipas nenit 3 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues sepse nuk posedon Certifikatën për kryerjen e programit *Ndërtimi i Kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës*.

Lidhur me këtë, Kolegji konstaton se komisioni për përzgjedhje me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me kriteret e konkursit dhe dispozitat e lartcekura të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues, andaj pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me atë se kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e konkursit sepse nuk ka certifikatën e udhëheqjes arsimore siç kërkohet me konkurs dhe udhëzimin administrativ përkatës në fuqi, janë të bazuara.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 01-111/01-0048306/19 i datës 04.07.2019, nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimet ankimore të ankuesit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Nga se u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazit “Frang Bardhi”, është zhvilluar në kundërshtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë*

e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës" dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues.

Bazuar në këtë Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, në pajtim me këtë vendim është i obliguar të zbatoj të njëjtin, sepse me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.


Sic u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 405/2019

Çlirim ZEKA


Procesmbajtës


Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
- Arkivit të KPMSHCK-së